



Prishtinë, 18 janar 2017  
Kodi i ZRRE-së: V\_880\_1\_2017

### Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energi

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15, paragrafi 1, nënparagradi 1.1, 1.1.5, 1.2 dhe 1.6, nënparagradi 1.2, Nenit 16, parografi 1; Nenit 51, paragrafi 1 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 26, Nenit 37 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr.05/L-085;
- Vlerësimi i Konkurrencës së tregut të energjisë përmes Indeksit të Herfindahl-Hirschman (HHI);
- Vendimin e Bordit të ZRRE-së të datës 30 mars 2011 lidhur me kriteret e matjes së konkurrencës, në seancën e mbajtur më 18 janar 2017 nxori këtë:

### V E N D I M

#### MBI VLERËSIMIN E KONKURRENCËS NË TREGUN E ENRGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË

- I. Sipas kritereve të përcaktuar në Vendimin e ZRRE-së V\_342\_2011, dhe Indeksit Herfindahl-Hirschman për tregun e energjisë elektrike në Kosovë, nuk ekziston konkurrencë efektive.
- II. Si pasojë e mungesës së konkurrencës efektive, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve të dhe parandalimin e abuzimit me pozitën dominuese të furnizimit me energji elektrike, ZRRE do të vendos Obligime të Shërbimit Publik mbi furnizuesin dominues për ofrimin e Shërbimit Universal me energji elektrike.

### ARSYETIM

- III. Liget e reja për sektorin e energjisë të cilat kanë hyrë në fuqi në korrik të vitit 2016, kanë sjellë ndryshime rrënjosore në sektorin e energjisë në Kosovë, sidomos në nivelin e gjenerimit dhe furnizimit me energji elektrike.
- IV. ZRRE ka bërë vlerësimin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, përmes Indeksin Herfindahl-Hirschman (HHI) e pjesëmarrjes të furnizuesve në treg dhe ka arritur në përfundim se vlera përkatëse deri më 31 dhjetor 2016 ka qenë 10,000. Vlerat e HHI janë në mes të vargut 0-10,000:

$$0 < HHI \leq 10,000$$

ku HHI llogaritet duke përdorur formulën në vijim:

$$HHI = \sum_{n=1}^N (S_n)^2$$

ku

$S_n$  është përqindja vjetore e energjisë elektrike të furnizuar tek të gjithë konsumatorët në Kosovë gjatë vitit 2016 nga furnizuesi i licensuar n, shprehur si përqindje; dhe



N       është numri i përgjithshëm i furnizuesve të licensuar me energji mbi zero të furnizuar tek konsumatorët në Kosovë në 2016.

dhe mund të interpretohet si në vijim:

- i. Vlerat më të vogla tregojnë industritë konkurruese, ndërsa vlerat më të mëdha tregojnë copëzimin në treg;  $HHI = 10,000$  në rastin e veqantë të një monopolit dhe nëse  $HHI \rightarrow 0$  (si  $N \rightarrow \infty$ ) është rasti i konkurrencës së përkryer. ZRRE nuk ka gjetur ndonjë arsyë për të përshtatur vlerësimin e ofruar në Direktivat e Komisionit Evropian në vlerësimin e lidhjes horizontale në kuadër të Rregullores së Këshillit mbi kontrollin e përqëndrimit ndërmjet ndërmarrjeve (2004/C 31/03), ku definimet e mëposhtme duhet të aplikohen:


$HHI < 1000$	tregjet e papërqendruara
$1500 \leq HHI \leq 2500$	tregjet mesatarisht të përqendruara
$HHI > 2500$	tregjet e përqendruara në masë të madhe


- ii. Për momentin janë tre [3] furnizues të licencuar për të furnizuar gjithë tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë. Megjithatë, deri në datën e këtij Vendimi, dy nga këta furnizues nuk janë bërë plotësisht aktiv, prandaj KESCO ende ka 100% të pjesëmarrjes në treg. Si rezultat i kësaj, HHI rezulton në vlerën 10,000, e cila tregon që tregu është i koncentruar vetëm në një furnizues dhe se nuk ekziston konkurrencë efektive.


- V. Ky vendim shfuqizon vendimin V-360-2011.
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

  
Krenar Bujupi, u.d. Kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Seffijaj anëtar